

## **Disa mendime për Bashkinë e Himarës për rritjen e efektivitetit të marketimit të rajonit”**

Stavri MARKO

Duke parë nevojën e domosdoshme të Krahinës së HIMARËS për zhvillim, parë gjithashtu në aspektet e vlerave turistike, në agrobiznes, në trashëgiminë kulturore, shoqërore dhe historike, jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajonin tonë, do të doja të paraqesja disa sugjerime pushtetit të autonomisë vendore të Bashkisë së Himarës. Mendoj se këto propozime, do të risin më tej vlerat e mëdha që paraqet e ardhmja e krahinës së Himarës dhe e gjithë “Akrokerauneve” në përgjithësi.

Propozimet janë studiuar në bazë të parametrave bashkëkohorë si në aspektet e të Drejtave të Njeriut dhe standarteve ndërkombëtare si dhe në bazë të legjislacionit dhe kushtetutës shqiptare.

Me këtë rast do të doja të propozoja konkretisht disa sugjerime për Bashkinë e Himarës.

### **SUGJERIMI 1.**

Të formohet një Bordi Këshillimor (modeli i të cilit funksionon në Himarë për mosmarrëveshjet e pronave) i cili do të shërbejë pranë Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të saj në formën e Këshillit të të Urtëve sipas traditës himariote. Gjithashtu cdo fshat mund të ngrejë një këshill të tillë.

### **SUGJERIMI 2.**

Bashkia e Himarës duhet të shpallë një konkurs me gjithë Komunitetet Himariote për të patur sa më shpejtë të jetë e mundur stemën dhe flamurin e saj, si mjet për identifikimin e vlerave kulturore historike dhe turistike të krahinës një trevë më se 6000 vjecare.

### **SUGJERIMI 3.**

Himara ka personalitete mbarë botërore dhe si e tillë është e nevojshme të bëhen sugjerime pranë Bashkisë së Himarës për dhënjen “Qytetarë Nderi” të asaj pjese që kanë kontribuar në përpjekjet për të ngritur lart emrin dhe qytetarinë e Himariotit si në Shqipëri dhe në botë në momente dhe kohë të ndryshme të historisë.

### **SUGJERIMI 4.**

Për ata persona me prejardhje nga Himara që simbolizojnë luftën dhe përpjekjet e lavdishme për të mbrojtur vlerat, pavarsinë dhe lavdinë e Himarës, të ngrihen dy ose tre monumente në qendër të Himarës. Sugjerime mund të sillen nga Komunitetet himariote dhe të aprovohen nga Këshilli Bashkiak i Himarës.

### **SUGJERIMI 5.**

Është më se e domosdoshme që Himara të ketë dokumentacionin e saj historik. Për këtë qëllim, ne sugjerojmë që Historia e Himarës e cila është një nga përpjekjet më të lavdishme dhe shëmbullit të pathyeshmërisë së krishtërimit, të ketë muzeun e saj duke pasqyruar vlerat reale shekullore. Kjo do të shërbejë njëkohësisht për të thyer përpjekjet e fallsifikatorëve të cilët duan të shtrëmbërojnë qëllimisht historinë e Himarës. Kjo vlen për çdo fshat, të cilët duhet të arshivojnë vlerat historike nëpërmjet fotografive dhe inventarizimin e dokumentacionit historik.

#### **SUGJERIMI 6.**

Cdo shtëpi e fshatrave të Himarës, është një dokument më vete me vlera kulturore historike, turistike. Për këtë qëllim, i del për detyrë komisionit të kulturës në Bashkinë e Himarës të evidentojë dhe bëjë të mundur ruajtjen si dhe studimin për të restauruar me ndihmë të donatorëve të huaj ose dhe vetë banorëve këto vlera që kanë gjithashtu të ardhura të shumta nga turizmi bashkëkohor. Gjithashtu, Bashkisë së Himarës i duhet të marë vendime energjike për të prishur objekte dhe sisteme infrastrukture jashtë konceptimeve moderne turistike, siç janë muret me blloqe betoni ose shkatërrimin e monopateve të fshatrave.

#### **SUGJERIMI 7.**

Të krijohen kushte sa më të përshtatshme që media himariote të ketë akses bashkëpunimi; Bashkia e Himarës dhe Diaspora për të prezantuar në Botë vlerat historike dhe turistike të krahinës për të thithur sa më shumë turistë kualitativë nga jashtë nëpërmjet Web- page-it himariot si pikë takimi e gjithë himariotëve në çdo pikë të globit. Gjithashtu të bëhen përpjekje financiare për të vënë në efikasitet të plotë televizionin lokal të Himarës.

#### **SUGJERIMI 8.**

Miratimi i një ditë feste për krahinën e Himarës ku të krijohet mundësia dhe hapësira për tu mbledhur fizikisht tërë krahinën e Himarës si dhe mundësitë e rahjes së mendimeve në të ardhmen për begatinë e krahinës sonë. .

#### **SUGJERIMI 9.**

Kombinimi i hapjes së sezonit turistik si dhe festës së ullirit si ngjarje kombëtare për promovimin e dy aktiviteteve kryesore që ka treva jonë. Të miratohet Guida Turistike e Himarës si dhe të bëhet azhornimin e Agjensive turistike brënda dhe jashtë vëndit.

#### **SUGJERIMI 10.**

Decentralizimi i Himarës nga Vlora dhe Saranda si mjet për shërbimin më të shpejtë të qytetarëve dhe Bashkisë. Duke parë vlerat historike, teritoriale, kulturore, fetare dhe komunitare, i sugjerohet autoriteteve vendore dhe administrative qëndrore që të shikojnë me përparësi Bashkimin e Bashkisë së Himarës me Komunën e Lukovës në një të vetme. Nga ky decentralizim, ne sugjerojmë në ndarjen e re teritoriale dhe administrative që Bashkia e Himarës të aprovohet në nivel Prefekturë.

#### **SUGJERIMI 11.**

Të inkurajohet Bashkia e Himarës për të vendosur në hapësirën e teritorit të vetë autonom, në të tria gjuhët shqip, greqisht dhe anglisht si shprehje e vullnetit komunitar, tabela për promovimin vëndeve kryesore të Himarës, të cilat do të prezantojnë kulturën dhe vlerat historike turistike të krahinës së Himarës. (Shëmbulli I Nartës le të shërbejë si model për Bashkinë e Himarës).

#### **SUGJERIMI 12.**

Diaspora e Himarës, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës, të bashkëpunojnë ngushtë për të bërë të mundur regjistrimin e gjëndjes civile në Himarë.

Kjo do ti shërbente mbi të gjitha krijimin dhe ruajtjes së harmonisë ndër-Himariote si dhe do të krijojë mundësinë që himarioti të ndjehet jo si i huaj në krahinën e tij.

Jam i bindur se Bashkia e Himarës si dhe Këshilli Bashkiak, diaspora dhe konsulenca e forumeve të shoqatave himariote si dhe ato ndërkomëtare, do të mund të gjejnë forcat për të vënë në jetë pikërisht këto propozime si dhe ato që do të dalin nga rezoluta finale e Konferencës Pan Himariote.

Vetëm duke qëndruar të bashkuar, porë në aspektin e unitetit shëmbëllor të himariotëve, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm për sfida të mëdha që na dalin në këtë rrugë të gjatë dhe të vështirë, për të ardhmen e brezave tanë. Ne duhet të vazhdojmë të krenohemi me historinë e pamposhtur të baballarëve tanë, me traditën e hekurt të nënave himariote që edukuan dhe skalitën në gurë, në breza, simbolin e himariotit.